

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA GJIROKASTER KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 02 datë 30 / 03/ 2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit të mëposhtëm përmbledhjen e datës 30.03.2026 ,relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

1. P/Vendim” Për tavanet përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2027-2029 në Bashkinë Gjirokastër”.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore“, ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjit nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit nr 23, datë 30.07.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit nr 7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, ju vendosim në dispozicion dokumentin “Tavanet Përgatitore Buxhetore në Nivel Programi për PBA 2027-2029 në Bashkinë Gjirokastër”

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Tavanet buxhetore janë hartuar mbi bazën e politikave të programeve, qëllimeve, objektivave për secilin prej tyre. Menaxhimi efektiv i financave publike është i lidhur direkt me përcaktimin e qartë të politikave. PBA është instrumenti parësor që lidh buxhetin vjetor me politikat e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Tavani buxhetor është maksimumi që mund të shpenzohet apo të planifikohet për një qëllim të caktuar.

Në zbatim të Udhëzimit nr.7, datë 27.02.2026 përgatitja e tavaneve si një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të programit të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të NJVQV-së, është vendosja e tavaneve të shpenzimeve. Një tavan në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që do të shpenzohen ose të planifikohen për t'u shpenzuar për një qëllim të caktuar.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

I.2 Granti i pakushtëzuar.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara të cilat përdoren në autonomi të plotë dhe transferta të kushtëzuara të cilat përdoren në mënyrë të përcaktuar nga organi që jep transfertën. Ligji i ri nr 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, përcakton qartë rregullat, politikat, instrumentat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në pushtetin vendor. Në zbatim të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, transferta e pakushtëzuar në një vit buxhetor është jo më pak se 1% e produktit të brendshëm bruto. Granti i pakushtëzuar nuk mund të jetë më i vogël se shuma e grantit e shpërndarë një vit më parë. Transferta e pakushtëzuar ndahet midis bashkive sipas formulës e cila konsiston por nuk kushtëzohet në a) popullsisë (harmonizim midis numrit të dhunave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), b) dendësinë e popullsisë për km², c) numrin faktik të nxënësve në shkollat 9-vjecare dhe të mesme në çdo bashki. Udhëzimit nr 7 datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029, Bashkia Gjirokastrë përfiton për periudhën afatmesme grant të

pakushtësuar për vitin 2027 në shumën 334,258 mijë Lekë, për vitin 2028 në vlerën 353,143 mijë Lekë, për vitin 2029 në vlerën 372,147 mijë Lekë.

I.3 Granti i pakushtëzuar sektorial.

Bazuar në udhëzimin nr 7, datë 27.02.2026 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, kreu V pika 82 citohet, “*Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas njesive të veteqeverisjes vendore per periudhen 2027-2029 do te kene nje rritje perkatesisht, 2% per vitet 2027-2028 dhe 1% per vitin 2029.*

I.3.1. Sipas përcaktimit të udhëzimit në kreun VI, pika 86 dhe 87, citohet “Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë; personeli mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jo mësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi I pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Bashkitë në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 duhet të parashikojnë fonde për ofrimin e infrastrukturës së përshtatshme për ushtrimin e funksionit të arsimit parashkollor.

1.4 Transferta e kushtëzuar

Sipas përcaktimit të udhëzimit në kreun VI, pika 88, citohet “Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2027-2029 në ministrinë përkatëse të linjës për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara në pushtetin vendor. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës”.

Sipas përcaktimeve të kreut III të udhëzimit nr 7, datë 27.02.2026, informacioni për të ardhurat afatmesme 2027-2029 i gjeneruar nga përdorimi i Sistemit të Menaxhimit Buxhetor Vendor paraqitet si më poshtë;

	Burimet Buxhetore	2024 Fakti	2025 Fakti	2026 Plani Fillestar	2026 Plani i Rishikuar	2027 Plani	2028 Plani	2029 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	209,061	214,570	256,632	256,632	259,197	259,975	260,756
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	41,643	42,969	52,274	52,274	52,798	52,952	53,113
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	34,196	34,838	41,453	41,453	41,868	41,992	42,118
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	5,041	5,185	7,352	7,352	7,426	7,447	7,470
1.1.3	Taksa mbi truallin	1,460	1,064	1,411	1,411	1,425	1,428	1,434
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	946	1,881	2,058	2,058	2,079	2,085	2,091
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	4,857	3,167	7,220	7,220	7,292	7,314	7,336
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,857	3,167	7,220	7,220	7,292	7,314	7,336
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	5,815	6,162	7,575	7,575	8,353	8,378	8,403
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	314	0	0	0	702	704	706
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	5,434	6,162	7,524	7,524	7,599	7,622	7,645
1.3.3	Taksa e tabelës	0	0	0	0	0	0	0
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	67	0	51	51	52	52	52
1.4	TARIFA VENDORE	131,764	138,977	155,668	155,668	156,521	156,994	157,464
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	46,012	47,665	53,588	53,588	54,122	54,286	54,449
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	6,515	6,759	7,363	7,363	7,436	7,459	7,481
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	30,471	30,198	31,657	31,657	31,975	32,071	32,167
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	10,860	11,711	7,263	7,263	7,336	7,358	7,380

1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	6,763	6,391	12,996	12,996	12,595	12,633	12,671
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	8,099	6,954	8,868	8,868	8,957	8,984	9,011
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	14,714	16,089	22,760	22,760	22,988	23,057	23,126
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	204	350	400	400	404	405	406
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	5,005	3,004	5,723	5,723	5,780	5,798	5,815
1.4.12	Tarifa të tjera	3,121	9,855	5,050	5,050	4,928	4,943	4,958
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	12,927	14,783	16,735	16,735	16,902	16,953	17,004
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	12,927	14,783	16,735	16,735	16,902	16,953	17,004
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	12,055	8,511	17,160	17,160	17,331	17,384	17,436
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestrime dhe zhvendëtime	1,019	318	2,130	2,130	2,151	2,158	2,164
1.6.3	Të tjera	11,036	8,193	15,030	15,030	15,180	15,226	15,272
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR	624,909	640,380	688,237	688,237	711,599	730,484	752,617
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	334,265	351,996	381,452	381,452	398,678	417,563	436,567
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	307,729	345,274	317,032	317,032	334,258	353,143	372,147
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	26,536	0	64,420	64,420	64,420	64,420	64,420
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	6,722	0	0	0	0	0
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	282,991	288,384	306,785	306,785	312,921	312,921	316,050

2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	19,374	19,956	20,554	20,554	20,965	20,965	21,175
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	103,271	121,925	131,263	131,263	133,889	133,889	135,228
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	30,632	31,855	40,822	40,822	41,638	41,638	42,055
2.2.4	Arsimi parauniversitar	7,396	7,692	9,528	9,528	9,718	9,718	9,815
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	37,489	45,863	47,364	47,364	48,312	48,312	48,795
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	8,407	8,743	10,454	10,454	10,663	10,663	10,770
2.2.8	Rrugët	9,481	9,778	10,074	10,074	10,276	10,276	10,379
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	10,852	11,286	12,126	12,126	12,368	12,368	12,492
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	26,120	30,837	24,600	24,600	25,092	25,092	25,343
2.2.12	Të tjera	29,969	449	0	0	0	0	0
2.3	TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA	7,653	0	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	7,653	0	0	0	0	0	0
2.4	TRANSFERTË SPECIFIKE	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transferte specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	41,185	41,734	43,368	43,368	43,803	43,934	44,065
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	27,463	24,784	28,218	28,218	28,501	28,587	28,672
3.2	Renta minerare	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	13,722	16,950	15,150	15,150	15,302	15,347	15,393
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	0	9,069	26,646	26,646	0	0	0
4.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	0	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	0	0	0	0	0	0
4.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	0	1,987	1,182	1,182	0	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	1,987	1,182	1,182	0	0	0
4.3	GRANTE TË HUAJA	0	7,082	25,464	25,464	0	0	0
4.3.1	Grante të huaja	0	7,082	25,464	25,464	0	0	0

5	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
6	TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR	234,325	314,878	109,305	109,305	110,000	110,000	110,000
6.1	Trashëgimi pa destinacion	224,075	302,305	99,305	99,305	100,000	100,000	100,000
6.2	Trashëgimi me destinacion	10,250	12,574	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV		1,109,480	1,220,631	1,124,189	1,124,189	1,124,599	1,144,393	1,167,438

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i Ekonomise, buxhetit, auditit te brendshem, zhvillimit strategjik., dhe keshilli bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Tavanet përgatitore të PBA në nivel programi, klasifikohen në llogaritë ekonomike (artikulli 600 +601) shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, (artikulli 602-606) shpenzimet operative, dhe llogaritë ekonomike (artikulli 230 + 231) shpenzime kapitale. Alokimi i fondeve për tavanet përgatitore, për llogaritë ekonomike 600+601 është bërë mbi nivelet e vitit 2026 dhe varjon rritja nga 1,5 % për cdo vit. Për llogarinë ekonomike 602-609 alokimi i fondeve të tavaneve është parashikuar 1% mbi nivelet e vitit 2026 dhe vazhdon rritja nga 2.5% për cdo vit. Parashikimi i tavaneve buxhetore për planin e investimeve është realizuar mbi bazën e objektivave dhe politikave të Bashkisë.

A është objekt i konsultimit publik:

jo

Komisioni i Përhershëm i i **“Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”**

i mbledhur me datën 30 / 03 / 2026, shqyrtoi projekt vendimiN:5

P/Vendim” Për tavanet përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2027-2029 në Bashkinë Gjirokastër”.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit


d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“


(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 30 / 03 / 2026 ORA 11:00